



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:234371
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876226

KPPP.nr.1761/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., Njësia Operative Rahovec, me NRB: 70465066, kundër debitorit A.M. B.I., - D.SH “EURO PARKU”, me seli në rrugën Muharrem Dina, në Rahovec, me NRB: 71009440, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.604/21 të datës 23.09.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës me datën 24.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET SI I PA AFAT prapësimi i debitorit A.M. B.I., - D.SH “EURO PARKU”, ndërsa Urdhri P.nr.604/21 i datës 23.09.2021, i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., Njësia Operative Rahovec, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.604/21 të datës 23.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-esktraktit nga Librat e Kontabilitetit me nr.LIII7513, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit Qershor 2018-Gusht 2021, bedna afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 486.00 Euro, me kamatë

ligjore prej 8%, dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi për përmbartim, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përmbartimor të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatës, debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.604/21 të datës 23.09.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjikë Radi, e ka pranuar me datë 28.09.2021, e cila vërtetohet nga fletëkthesa e Përmbartuesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është dorëzuar me datën 06.10.2021, e cila vërtetohet nga vula e postës së rregullt që gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme”*.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.604/21 të datës 23.09.2021, e ka pranuar me datën 28.09.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 29.09.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 05.10.2021, por debitori prapësimin e ka dorëzuar në postë me datën 06.10.2021, dhe nga kjo rezulton se prapësimi është dorëzuar 1 (një) ditë me vonesë.

Rrjedhimisht, meqenëse është konstatuar pasafatshmëria, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga debitori dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1761/23, me datë 24.06.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.